

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO OLIVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO ZMRA E KRYEMINISTRIT - KURD PRIMJERI - OFFICE OF THE PRIME MINISTER
Nr. Org. Org. Unit	01
Nr. Fajeve Br. Stranica Nr. Pages	- 10 -
Nr. Prot. Reg. No. Prot. No.	(059/19)
Date: Ditë/Stranica Date:	10/04/2018
Prishtinë/a	



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIJA E DIASPORES DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE - MINISTRY OF DIASPORA AND STRATEGIC INVESTMENTS STRATEŠKI ULAGANJA - MINISTRY OF DIASPORA AND STRATEGIC INVESTMENTS
Njësh. Org. Org. Jedinica Org. Unit	01-4
Nr. Fajeve Br. Stranica Nr. Pages	14
Nr. Prot. Reg. No. Prot. No.	350
Date: Ditë/Stranica Date:	10/04/2018
Prishtinë/a	

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republie of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike – Ministarstvo za Dijasporu i
Strateška Ulaganja - Ministry of Diaspora and Strategic Investments

REFERENCE:					
PËR/ZA/TO:		Ramush Haradinaj – Kryeministër i Republikës së Kosovës			
CC:		Dardan Gashi - Zv. Kryeministër & Minister i Diaspores dhe Investimeve Strategjike			
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:		Afrim Bekteshi, Zv. Ministër i Diaspores dhe Investimeve Strategjike			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Raport për muajt: Dhjetor 2017, Janar, Shkurt, Mars dhe 10 ditësh i parë i Prillit 2018			
Nr. i zyrës: Br. kaneelarije: Room No.:	110	Lokacioni: Kueni: Extension:	Ndërtesa: Ish Gjykata Themelore	Datum: Data e raportit	10.04.2018

Inderuari Kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj,

Nga takim i zhvilluar më datë, 28. dhjetor, 2017, ndërmjet jush si Kryeministër i Republikës së Kosovës dhe Zëvendësministrave, keni kërkuar që secili zëvendësministër të merr detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara brenda Dikasterëve, ku janë të emëruar me vendim tuajin z. Kryeministër. Njëkohësisht keni kërkuar që deri më datë, 10. Prill, 2018, secili nga ne, të paraqet një raport me shkrim për 100-ditëshin e dytë të qeverisjes, rrëth punëve konkrete që janë bërë nëpër ministritë përkatëse.

Meqë, si zëvendësministër i Diaspores dhe Investimeve Strategjike jam emëruar kah gjysma e muajit nëntor 2017, atëherë më lejoni të ju sqarojë se angazhimin e duhur e kam nisur tek në fillim të muajit Dhjetor. Si rrijedhojë, po ju përejelli reportin për tërë muajt e angazhimit tim të deritanishëm pranë Ministrisë së Diaspores dhe Investimeve Strategjike, e që i bie se ky rapport përban një përvaksim pak më të gjatë se 100 ditë.

Konsiderojë se mënyra e një raportimi të përformances së zëvendësministrave, tregon më së miri se Qeveria e Republike së Kosovës, në krye me Ju z.Kryeministër, është tejet e përgjegjshme dhe shumë transparente, në rapport me qytetarin.

Në vijim, po ua përejelli reportin përbledhës për muajt:

Dhjetor 2017, Janar, Shkurt dhe Mars, 2018 dhe 10 ditëshin e parë të Prillit 2018

Paraprakisht, ju falenderojë për mirëkuptimin tuaj!

Afrim Bekteshi, Zv. Ministër i MDS

HYRJE

Ky raport paraqet detyrat e caktuara, punët e kryera dhe ato në vazhdim, pjesëmarrjen nëpër takime të niveleve të ndryshme, si dhe përbledhje nga secila vizitë zyrtare të realizuar jashtë vendit.

Gjatë kësaj periudhe, të gjitha këto aktivitete të kryera, kanë qenë në përputhje të plotë me rregullat dhe udhëzimet që përcakton Ministria e Diaspores dhe Investimeve Strategjike, poashtu edhe në dijeni të plotë nga Zv.Kryeministri, njëherësh Ministri i Diaspores dhe Investimeve Strategjike, z. Dardan Gashi.

Konsiderojë se qëllimet kryesore të deritanishme brenda kësaj periudhe, kanë qenë në përbushjen e prioriteteve që ka Ministria e Diaspores dhe Investimeve Strategjike brenda kësaj periudhe, e që kanë të bëjnë me rritjen e dinamikes brenda Ministrisë, në kontekst të një funksionalizimi sa më të duhur brenda Ministrisë së Diaspores dhe Investimeve Strategjike.

Afrim Bekteshi,
Zv. Ministër i Diaspores dhe Investimeve Strategjike

Takimi i parë me Zv.Kryeministrin, njëherit Ministrin e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, z.Dardan Gashi, ishte më datë, 27. Nëntor, 2017.



- Ishte ky një takim njostues, por njëkohësht edhe një takim pune. Pas një prezentimi të shkurtër, e njostova Ministrin që i takojë profilit të ekonomisë. Meqë, në kuader të Ministrisë së Diaspores dhë Investimeve Strategjike, ekziston Departamenti për Hulumtime dhe Përkrahje të Investimeve të Diasporës dhe muajve në vijim poashtu do t'i shtohet edhe një Department i ri, ai i Investimeve Strategjike, atëherë u dakordua që ndarja e detyrave dhe përgjegjësive për mua të jetë e caktuar në fushat me prioritet, si nxitja dhe përkrahja e Investimeve nga Diaspora jonë dhë poashtu të Investimeve Strategjike, gjithmonë në kooperim me Ministrinë e Linjës, si MTI, MZHE, por edhe Agjencitë përkatëse që trajtojnë këto çështje, ku unë si zv.Ministër do të ndihmojë në hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e politikave të ministrisë së Diasporës në këtë fushë.....
- Në kuadër të Ministrisë së Diaspores dhe Investimeve Strategjike janë gjithsejtë pesë Departamente, ku këto Departamente në vete ngërthejnë nëntë divizione. Andaj, për t'u ambientuar sa më shpejtë me Ministrinë, kam filluar menjëherë takimet me drejtorët e Departamenteve brenda Ministrisë së Diasporës, dhe me udhëheqësit e këtyre Divizioneve. Këto takime janë zhvilluar me qëllim që të njostohem për së afërmni me aktivitetet dhe punët e këtyre Departamenteve dhe për ti koordinuar punët ndërmjet stafit politik dhe atij civil në vazhdim, për të ecur kështu bashkarisht drejtë realizimit të objektivave të përbashkëta.
- Nga kjo, ka rezultuar informacioni i mjaftueshëm rrëth punëve të kryera dhe atyre që janë me prioritet për Ministrinë, me ç'rast mu dha mundësia për të patur çasje edhe në raportet e punës nga secili Departament, gjithmonë me dijeninë edhe të Sekretarit të Përgjithshëm të MDIS.


Më datë 08.12.2017, në zyren time pata nderin të pres Konsullen e Republikës së Kosovës në Stuttgart të Gjermanisë, znj. Bahrije Hoti.

- Ishte ky një takim frytdhënës, ku bashkëbiseduam mbi ecurinë e punëve të Konsullates dhe Sherbimeve Konsullore për Diasporën, si dhe koordinimin e aktiviteteve të ardhshme ndërmjet Ministrisë së Diaspores dhe Investimeve Strategjike dhe Konsullates së Republikës së Kosovës në Stuttgart të Gjermanisë!




Më datë 11. Dhjetor, 2017, në cilësinë e Zv/Ministrit të Diaspores dhe Investimeve Strategjike, isha pjesëmarrës në Takimin e Forumit të Nivelit të Lartë.

- Forum i organizuar nga Ministria e Integrimeve Europiane, ku qëllimi i këtij Forumi ishte dhe mbetet rritja e efektivitetit të ndihmës që i ofrohet Kosovës, e që ka si bazament arrijen e rezultateve të përbashkëta të Qeverisë së Kosovës dhe të Donatorëve!




Më datë 11. Dhjetor, 2017, në agjendën ditore, pata edhe takimin e parë me Këshillin Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi.

- Në këtë Këshill janë anëtarë dhe qysh në takimin e parë, pata rastin që përmes fjalës time të shpërfaqë mundësitet ndërveprimi ndërminstrov. Aty propozova se iniciimi i aktiviteteve inovative në Kosovë, duhet të bëhet në bashkërendim edhe me komunitetin tonë në diasporë, ngase atje kemi ndërmarrës shumë të suksesshëm, ku afarojnë suksesshëm me biznesin e tyre dhe si shembull, ato ide dhe ajo eksperiencë pse mos të sillet edhe në Kosovë.




Vizitë e realizuar në Malmö – Suedi

- Më datë 18. Dhjetor, 2017, realizova viziten e parë zyrtare në Suedi (Malmö). Pata takim shumë të rëndësishëm në “Invest in skåne”, ku nga afër u njoftova për të arriturat e këtij Institucioni (Autoriteti Regional), lidhur me nxitjen e Investimeve Strategjike. Ky institucion i madhë regional në fushen e inovacionit, i ka dhënë botes, ultrazanin e parë medicinal, Sony Eriksonin, Bluetooth-in, Candy crush, Tetrapakun, e shumë e shumë zbulime të tjera inovative. Përmes një prezantimi dhe qasje të drejtpërdrejtë, pata mundësinë të kuptojë se si hartohet një strategji e mirëfilltë, për nxitjen e investimeve strategjike.



Gjatë vizitës në Suedi, takim me Drejtoren Naim Sadiku

- Takim tjetër pata edhe në Qendren Kulturore të Kosoves në Malmö, me ç'rast u takova me kryetar Naim Sadikun, me të cilin bashkëbisedua për të arriturat e deritanishme të kësaj Qendre, si dhe për hapat e mëtutjeshëm, në kontekst të organizimit dhe avancimit të vlerave kulturore këtu në Suedi. Si ruajtjen e identitetit kulturor, gjuhësor, dhe traditave shqiptare në përgjithësi. Poashtu takova disa nga antarët e Rrjetit të Biznesit Shqiptar në Suedi, me të cilët diskutuan rreth mënyres së riorganizimit të rrjetit, sepse deri atëherë nuk kishte qenë funksional. Në emër të Ministrisë së Diaspores dhe Investimeve Strategjike si titullar i formimit të këtij Rrjeti, kërkova që të mbahet një takim i radhes me qëllim të rizgjedhjes së një kryesie të re, përkatësisht udhëheqësisë së re të këtij Rrjeti në Suedi. Disa nga antarët e Rrjetit u zotuan që do të merren intesivisht me këtë temë, me ç'rast edhe kemi rezultate konkrete sa i përket Rrjetit të Biznesit në Suedi, rezultate këto që do i shpalosim si më poshtë në këtë raport.....



Detyrat e ndara nga Ministria - Ministri z. Dardan Gashi

- Më datë, 17. 01 2018, me qëllim të realizimit të detyrave dhe planit të Ministrisë së Diaspores dhe Investimeve Strategjike, ministri z. Dardan Gashi përmes një shkresë drejtuar neve si zëvendësministra, na ndau detyrat si më poshtë:

Në bashkëpunim me Stafin Politik të Kabinetit të Ministrat, Sekretaren e Përgjithshme dhe me departamentet përkatëse të Ministrisë, duhet të bëhet një raport, që do të ketë për qëllim zbatimin dhe realizimin e objektivave të dalura nga strategjia për Diasporën dhe Mërgatën për vitet 2013-2018 dhe planin e veprimit, plan ky që kërkon realizim deri në fund të këtij viti si:

- a) Promovimi dhe avancimi i të drejtave politike dhe sociale të diasporës
- b) Ruajtja e identitetit dhe fuqizimi i lidhjeve me diasporën
- c) Integrimi i pjesëtarëve të diasporës në shtetet ku jetojnë
- d) Lehtësimi i përfshirjes së diasporës në zhvillimin socio-ekonomik

Poashthu, pas analizimit dhe dhe shqyrtimit të kësaj strategjie, n'a u është kërkuar nxerrja e rekomandimeve për hartimin e projektstrategjisë për Diasporën për vitet e ardhshme, 2019-2024, ku zëvendësministrave do tu caktohet një fushë përkatëse, në procesin e hartimit të strategjisë së re për Diasporën për periudhen 2019-2024, sipas planit të përgatitur nga Komisioni Qeveritar për hartimin e strategjisë për Diasporën, që do të themelohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ndër detyrat e ndara me prioritet nga Ministri z. Dardan Gashi janë si:



Inicimi për eliminimin Barrierave në lidhje me pagesat për sigurimin kufitar të automjeteve (Kartoni i Gjelbër), për Diasporën, ku sa për informacion vlenë të theksohet se bazuar në këtë nismë, është nënshkruar Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, nga Minstria e Punëve të Brendshme dhe Byroja Kosovare e Sigurimit, prandaj si detyrë për ne është, përcjellja e vazhdueshme e implementimit të këtij memorandumi deri në rrealizimin e plotë.

Gjithashtu detyrë tjetër me prioritet mbetet edhe përcjellja e zbatimit të marrëveshjeve bilaterale, të nënshkruara ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, si më poshtë:

- a) Marrëveshja për Qendrat Kulturore të përbashkëta
- b) Marrëveshja për bashkëpunim në fushen e Diasporës dhe Migracionit
- c) Marrëveshja për financimin dhe organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kultures shqiptare në Diasporë.

Më datë 19. Janar. 2018, takim pune në MTI,


- U prita nga Zv.Ministri Faton Thaqi, nga Shefi i Kabinetit, njëherit Këshilltar i Lartë Politik, z. Durim Limaj, si dhe Nol Buzhala nga **KIESA**. Nën frymen e bashkëpunimit, diskutuan për koordinimin dhe ndërveprimin mes Ministrisë së Diaspores dhe Investimeve Strategjike dhe MTI-së, gjithçka që lidhet me promovimin dhe nxitjen e Investimeve në Republikën e Kosovës.
- Ndërsa më datë **22. Janar. 2018**, pata një takim konsultativ në Ministrinë e Administratës Publike, ku u prita nga Ministri z. Mahir Yageilar dhe Zv.Ministri z. Sami Hajdaraj. Takimi kishte karakter konsultativ, rreth plotësim ndryshimit të rregullores së re të Ministrisë së Diaspores dhe Investimeve Strategjike, në mënyrë që rregullorja e re të mos bie ndesh kompetencash me MTI-në.



Përgjithësisht, ishte pra një takim konstruktiv, rreth temave ndërmistrore!

Vizitë e realizuar në Mynih të Gjermanisë, 17.Shkurt. 2018

- Në vigjilje të 10 vjetorit të shtetësisë së Kosovës, më datë **17.Shkurt. 2018**, isha pjesëmarrës në manifestimet që u mbajtën me Diasporen, në Mynih të Gjermanisë. Ku e tërë rrjedha e takimeve u realizua sipas agjendës së paraparë. Edhe pse nën atmosferën festive, megjithatë vizita pat karakter pune, ku në theks të veçantë ishte Seminar i mbajtur me Mësuesit e Mësimit Plotësues të Gjuhes Shqipe. Seminar me tema të ndryshme, por me të vetmin qëllim, ruajtjen dhe kultivimin e gjuhes, kultures, trashigimisë dhe traditave kombëtare shqiptare në Diasporë. Puna e deritanishme e tyre, për nga rëndësia ishte e dyfishtë; e para, Ata shpirtnisht po vazhdonin të ruanin gjuhen dhe identitetin shqiptarë dhe e dyta, ata lehtësisht po krijonin alternativa integruese në shtetin pritës.



Më datë 18. Shkurt. 2018, vizitë në Schongau të Bavarisë.

- Aty ishte organizuar një Event përnderë të 10 vjetorit të formimit të klubit futbollistik FC "Kosova", ku isha stuar nga drejtori z. Hafir Elshani. Event ky që koincidonte edhe me 10 vjetorin pavarësisë së Kosovës. Aty, në emër të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike me një fjalë rastit përcolla urimet përnderë të 10-të vjetorit jubile të pavarësisë së Kosovës, qindra të pranishmëve, bashkëatdhetarë tanë që jetojnë dhe veprojnë atje.

Më datë 19. Shkurt. 2018, vizitë në Mynih në klubin tjetër futbollistik poashtu me emrin e njëjtë FC "Kosova"

- Këtu isha i stuar nga kryetar i klubit Arben Kelmendi. Gjithashu, pata knaqësinë të takoja përsosialitete të ndryshme, kontributdhënës të mëdhenjë për diten që po gjëzojmë sot pavarësinë e Kosovës. Ndër ta ishte edhe Ambasadori i Republikës së Kosovës në Berlin, z. Astrit Zemaj. Gjithkund, nga këto takime u përqua mesazhi për shtetëndërtimin e Kosovës, për ngritjen e vlerave kombëtare dhe të imazhit të saj nëpër botë.

Vizitë e realizuar në Malmö të Suedisë më 5. Mars. 2018

- Me ftesë të Shoqatës Shqiptaro-Suedez "Meshari", realizova vizitën e dytë në Malmo të Suedisë. Vlenë të potencohet se qëllimi kryesor i vizites së dytë brenda një afati të shkurtër pikërisht në Malmö të Suedisë, ishte për të parë nga afér ndryshimet që kishin ndodhur me Rrjetin e Biznesit në Suedi. Pas vizitës së parë që e pata, ku me propozimin tim u patem dakorduar që të mbahej një takim me anëtarët e Rrjetit, në mënyrë që të zgjidhen udhëheqësit e rinjë të RRBSHS-së. Kjo tashmë kishte ndodhur dhe ky Rrjet ka Kryesinë e re, ku kryetar i Rrjetit është zgjedhur z. Halim Hoti, biznesmen i suksesshëm në Suedi, i cili gjeneron të hyra vjetore milionëshe, ndërsa nënkyetar i Rrjetit është zgjedhur Milaim Makoll, një biznesmen poashtu i suksesshëm në Suedi. Me kryetarin dhe nëkryetarin e ri të Rrjetit u dakordua që të fillojnë kontaktet me të gjithë biznesmenët shqiptar në Suedi dhe




njëkohësisht të fillojnë me parapërgatitjen e organizimit të një Sesioni informues rreth klimës së investimeve në Kosovë, në bashkëkoordinim me Ambasaden e Kosovës atje.

Takim me drejtorin e Qendrës Kulturore të Kosovës në Malmö, z. Naim Sadiku,


- Takim tjetër gjatë kësaj vizite pata edhe në Qendrën Kulturore të Kosovës në Malmö, ku u takova me drejtorin e kësaj qendre, z. Naim Sadiku. Me të diskutua rreth temave që kanë të bëjnë me Qendrën dhe aktivitetet e saja për vitin 2018-të, sipas PVP-së të nxjerrur nga Ministria e Diaspores dhe Investimeve Strategjike.

Takim me nënkyrytarin e Komunes së Malmös, i cili vjen nga trevat shqiptare (Maqedonia), z. Sadat Arifi.



- Të arriturat e shqiptarëve në Suedi janë të mëdhaja edhe në politikë. Së këndejmi, isha i stuar ta takoja nënkyrytarin e Komunes së Malmös, i cili vjen nga trevat shqiptare (Maqedonia), z. Sadat Arifi. Me të cilin biseduam rreth mënyrës së investimeve në Kosovë nga Diaspora jonë. Fillimi është e kontaktit me ta, e më pastaj promovimi dhe nxiti për të investuar në Kosovë. Ishte një takim tejet konstruktiv, duke u dakorduar kështu për aranzhimin e takimeve tjera edhe në të ardhmen, konkrete.

Takimi përmbylles ishte me konsullin e Republikës së Kosovës në Kopenhangë (Danimarkë), z. Artan Krasniqi.



- Edhe pse në fillim të angazhimeve të tij në cilësinë e Konsullit të Kosovës në Danimarkë, çasja e tij prej një përsaqësuesi shtetëror, si dhe sherbimeve konsullore për bashkëatdhatarët tanë, ishte konkrete. Biseda me Konsullin ishte në fokus të investimeve në Kosovë dhe krijimi i mundësive dhe kontaktave me investitor, qofshin ata pjesëtarë të Mërgates sonë, apo investitor të huaj. U dakordua që trinomi, Ministri e Diaspores - Qendrat Kulturore në Diasporë - Përsaqësítë konsullore në shtetet përkatëse, duhet të jenë në nivelin e duhur dhe në koordinim të plotë, sa i përket trajtimit të duhur dhe të nevojshëm për bashkëatdhatarët dhe veçanërisht në tërheqjen e investimeve në Kosovë.

Vizitë e realizuar në Malmö të Suedisë më 7. Prill. 2018

- Kryesia e re e Rrjetit të Bizneseve Shqiptare në Suedi është duke bërë një punë të shkelqyer, marrë parasysh kohen shumë të shkurtër që nga ristrukturimi i saj, duke bërë një sërë takimesh me biznesmen të suksesshëm atje, ku si rrjedhojë më datë, 7.Prill.2018, në Malmö patëm Sesionin e parë informues “**Klima e Investimeve në Kosovë**”, që për qëllim patë nxitjen e investimeve të Diaspores në Kosovë. Ky takim është organizuar në bashkëpunim ndërmjet RRBSHS-së dhe Ambasadës së Republikës së Kosovës dhe është mbajtur në Qendrën Kulturore të Kosovës në Malmo. Ky takim u mbajtë me biznesmen të stuar jo vetem nga Suedia por edhe nga shtetet tjera skandinave, si Norvegjia dhe Finlanda, e që nga Kosova, përveç pjesëmarrjes së Zv.Kryeministrit, z.Fatmir Limaj dhe unë si Zv.Ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, ishin pjesëmarrës edhe Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë-KIESA, nga Administrata Tatimore e Kosovës, nga Doganat e Republikës së Kosovës, nga Departamenti Qendror për Partneritet Publiko-Privat, nga Agjencia Kosovare e Privatizimit(AKP), nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterines(AUV).
- Me nga një fjalë rasti të pranishmëve iu drejtuan , Zv.Kryeministri i Republikës së Kosovës, z.Fatmir Limaj, zt.Sedat Burriku, i ngarkuari me punë Ambasador i Kosovës në Suedi, zt. Guner Urcya, udhëheqës departamentit për diplomacy ekonomike nga MPJ, si dhe Nënkyetari i Rrjetit të Bizneseve në Suedi, z. Milaim Makolli.



Ishë takim tejet i frytshëm dhe informues me temën "**Klima e Investimeve në Kosovë**", ku patëm mundësinë që në formë pakojë përbledhëse, të ofrojmë mundësitë për investime në Kosovë, për afaristët shqiptarë nga Skandinavia. Prezenca e nivelit të lartë shtetëror e Zëvendëskryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Fatmir Limaj, i dha madhështinë këtij takimi.

Ishë interesim i madhi për investime në Kosovë, derisa presim që ky takim të sjellë së shpejtë rezultatet e para, në mënyrë që të shohim koncentrimin e kapitalit investiv, nga Diaspora në Kosovë...

Detyrat të cilat i kemi para vetës.....

Në vazhdën e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Diaspores dhe Investimeve Strategjike me Komunat e Kosovës, (përfshirë zyrat koordinuese komunale për Diasporën), së këndejmi duke marrë parasysh një mori çështjesh që kanë impakt direkt me bashkëatdhatarët tanë në Diasporë, nisur që nga shërbimet e nevojshme dhe krijimin e lehtësirave për ta, e deri tek nxitja e investimeve nga Diaspora, më datë 08. 03. 2018, përmes një shkresë ju drejtova të gjithë kryetarëve të komunave të Kosovës, duke kërkuar takim dhe bashkëbisedim me ta.

Qëllimi i këtyre takimeve është, që për së afërmë të njostohemi për arsyet e mundshme të bashkëpunimit dhe interesit reciprok shumëdimensional ndërmjet Komunave të Kosovës dhe Ministrisë së Diaspores dhe Investimeve Strategjike.

Me të njejtën shkresë iu drejtova edhe Asociacionit të Komunave të Kosovës, respektivisht Drejtorit Ekzekutiv të Asociacionit të Komunave, z. Sazan Ibrahim, që në takimin e mundshëm të radhës me përsaqësues komunal, (me Kryetarët e Komunave) të na ftojë edhe Në si Ministri e Diaspores, në mënyrë që të ndërveprojmë për çështjet me interes dypalësh.

Këto takime, synoj ti realizoi brenda mujit prill dhe maj, në mënyrë që para fluksit të ardhur nga Diaspora për pushime verore, të mund të kemi ndonjë plan veprimi më konkret, më praktik për ofrimin e shërbimeve për mërgimtarët. Kjo ide ka rrjedhë si pasojë e ankesave të shumta nga Diaspora, adresuar nivelit komunal, lidhur me mosofrimin e duhur dhe të nevojshëm të shërbimeve komunale, gjatë kohes së fluksit të mërgimtarëve që vijnë në Kosovë.

Kështu (si më poshtë), përgatila agjenden e vizitave nëpër komuna, të cilat do ti vizitojë sipas agjendës së paraparë me qëllimin që:

Së pari - të njostohemi për së afërmë për arsyet e mundshme të bashkëpunimit dhe interesit reciprok shumëdimensional ndërmjet Komunave të Kosovës dhe Ministrisë së Diaspores dhe Investimeve Strategjike.

Së dyti - Krijimin i lehtësirave për ofrimin e duhur dhe të nevojshëm të shërbimeve komunale, gjatë kohes së fluksit të mërgimtarëve që vijnë në Kosovë

Së terti - Çfarë mund të ofrojnë komunat e Kosovës për investitorët potencial nga Diaspora

Atrim Bekteshi Zv. Minister i MDIS

- **Agjenda:** Takim me Komunat e Kosovës
- **Tema:** Mundësitet e bashkëpunimit shumëdimensional, ndërmjetë Komunave të Kosovës dhe MDIS



REPUBLIKË KOSOVË
MINISTRIA E DIASPORES DHE
INVESTIMEVE STRATEGJIKE

Data	Vendi / Koha	Temat Kryesore:	Pjesëmarrës në takim	Nr.Tel	Shtesë
	1.Pejë 10:00 2.Deçan 13:00 3.Junik 15:00	1.Ofrimi i shërbimeve për Diasporen, nëpër Komuna 2.Krijimi i lehtësirave 3. Çfarë ofron Komuna për investitorët nga Diaspora	Zv.Ministër - Afrim Bekteshi Kryetar-Gazmend Muhaxheri Kryetar - Bashkim Ramosaj Kryetar - Agron Kuqi	039 / 434-603 0390/361-785 0390/502-646	
	4.Gjakovë 10:00 5.Klinë 13:00 6.Istog 15:00		Kryetar – Ardian Gjini Kryetar – Zenun Elezaj Kryetar – Haki Rugova	0390/330-183 039/471-306 039/451-219	
	7.Vushtrri 10:00 8.Mitrovicë 13:00 9.Skenderaj 15:00		Kryetar – Xhafer Tahiri Kryetar – Agim Bahtiri Kryetar – Bekim Jashari	028/570-601 028/530-201 028/582-522	
	10.Obiliq 10:00 11.F.Kosovë 13:00 12.Drenas 15:00		Kryetar – Xhafer Gashi Kryetar – Burim Berisha Kryetar – Ramiz Lladrovci	038/561-322 038/536-005 038/584-353	
	13.Lipjan 10:00 14.Shtime 13:00 15.Ferizaj 15:00		Kryetar – Imri Ahmeti Kryetar – Naim Ismajli Kryetar – Agim Aliu	038 / 581-214 0290/389-009 0290/327-000	
	16.Kamenicë 10:00 17.Gjilan 13:00 18.Viti 15:00		Kryetar – Qendron Kastrati Kryetar – Lutfi Haziri Kryetar – Sokol Haliti	0280/371-969 0280/320-781 0280/381-626	
	19.Dragash 10:00 20.Prizren 13:00 21.Suharekë 15:00		Kryetar – Shaban Shabani Kryetar – Mytaher Haskuka Kryetar – Bali Muharremaj	029/281-543 038/200-44-700 029/271-267	
	22.Mamushë 10:00 23.Rahovec 13:00 24.Malishevë 15:00		Kryetar – Abdyladil Krasniqi Kryetar – Smajl Latifi Kryetar – Ragip Begaj	029/273-260 029/276-943 029/269-008	
	25.Podujevë 11:00 26.Prishtinë 15:00		Kryetar – Agim Veliu Kryetar – Shpend Ahmeti	0290/327-000 038/245-348	
	27.Kaçanik 11:00 28.H. Elezit 15:00		Kryetar – Besim Ilazi Kryetar – Ruski Suma	0290/380-005	

Përfundim

Inderuari Kryeministër i Oeverisë së Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj

- Ashtu siç e kemi cekur në hyrje të këtij raporti, dua të potencoii edhe njëherë se ky raport ka paraqitur detyrat e caktuara, punët e kryera dhe ato që i kemi në vazhdim, si dhe pjesëmarrjen nëpër takime të niveleve të ndryshme dhe përbledhje nga secila vizitë zyrtare të realizuar jashtë vendit.

Inderuari Kryeministër i Oeverisë së Republikës së Kosovës, Z. Ramush Haradinaj

- Gjatë periudhës raportuese nga dt. 01 dhjetor 2017, deri më 10 prill 2018, unë Afrim Bekteshi zëvendësministër i Diaspores dhe Investimeve Strategjike, kam bërë përpjekje të vazhdueshme që çdo aktivitet dhe detyrë timen, ta kryej sipas rregullave dhe udhëzimeve që janë në përputhje të plotë me Ministrinë përkatëse, për aq sa kam patur hapsirë dhe mundësi veprimi dhe për aq sa kam qenë i deleguar nga Ministri i Diaspores dhe Investimeve Strategjike, z. Dardan Gashi, për të kryer ndonjë detyrë të dhënë.
- Dua të potencoii poashtu se ekzistojnë mundësítë dhe kapacitetet për të bërë akoma më shumë, gjithmonë në të mirën e përgjithshme institucionale dhe shtetërore, por kjo nuk mvaret vetëm nga dëshira dhe vullneti im personal, por konsiderojë se kjo mvaret edhe nga fakti se, sa jam i autorizuar për kryerjen e detyrave të caktuara nga Ministria.
- Poashtu dua të besojë se tashmë gjatë muajve në vijim, do të kemi intensifikim të aktiviteteve brenda Ministrisë dhe rritje të dinamikës në realizimin e aktiviteve sipas matriksit vjetor të planit të veprimit për vitin 2018, e që për rrjedhojë besojë se do të kam edhe angazhime të shtuara që kërkojnë realizim nga unë si zëvendësministër.

Aktivitetet kryesore që janë realizuar gjatë periudhës raportuese, rezultojnë me sa vijon:

Aktivitet kryesor që është realizuar gjatë periudhës raportuese, e që ka rezultuar si produktiv është:

- Ristrukturimi dhe njëkohësisht rifulksionalizimi i kryesisë e re të Rrjetit të Bizneseve Shqiptare në Suedi, rrjet ky që ka qenë totalisht pasiv para vizitës time zyrtare të bërë në Suedi, ku filluan përpjekjet e para për ta riorganizuar përsëri këtë Rrjet.
- Duke qenë të vetëdijshëm se përmes nxitjes së Investitorëve nga Diaspora jonë, e që përmes tyre mund të kemi edhe nxitje të investimeve të huaja direkte nga vendet pritëse ku janë të përqendruar shqiptarët, atëherë pikërisht për shkak të këtij qëllimi, parësore për mua ishte që këtë Rrjet ta fusim në funksion, ngase Suedia është dhe mbetet një vend që ka shqiptarë biznesmen shumë të suksesshëm.
- Tani më ky Rrjet është duke bërë një punë të shkelqyer, marrë parasysh kohen shumë të shkurtër që nga ristrukturimi. Ky rrjet ka bërë një sërë takimesh me biznesmen të suksesshëm atje, ku si rrjedhojë e saj më datë, **7.Prill.2018**, në Malmö patëm Sesionin e parë informues “**Klima e Investimeve në Kosovë**”, që për qëllim patë nxitjen e investimeve të Diaspores në Kosovë, derisa presim që ky takim të sjellë së shpejtë edhe rezultatet e para, në mënyrë që të shohim koncentrimin e kapitalit investiv, nga Diaspora në Kosovë...

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj!

Afrim Bekteshi,
Zëvendësministër i Diaspores dhe Investimeve Strategjike